



PROSPEKT

FOND I HAPUR INVESTIMI

WVP TOP INVEST

Shoqëria për administrimin e Fondeve Investuese WVP Fund Management Tirana sh.a,
Rr. Barrikadave, Nr.118/ Kati 4, Apt.1, 1001 Tiranë, Shqipëri
www.wvpfunds.al : contact@wvpfunds.al
tel: +355 4 22 24 525

Hyrje

Ky Prospekt përmban të gjithë informacionin e nevojshëm, në mënyrë që investitorët potencialë të jenë në gjendje të bëjnë vlerësimet e duhura mbi objektivat dhe strategjitë kryesore të fondit të hapur të investimit WVP TOP INVEST (në vijim: Fondi), mbi rreziqet e investimit në të, profilin e investitorit të përshtatshëm si dhe mbi tarifat e fondit.

Informacioni i dhënë në këtë Prospekt është shprehur ndershmërisht, për të orientuar investitorët. Çdo opinion, parashikim i përmendur nuk ka për qëllim keq informimin e investitorit. Janë kryer të gjitha kërkimet e duhura për të konstatuar dhe verifikuar për sa më sipër.

Për çdo investitor është e këshillueshme ta lexojë këtë prospekt përpara marrjes së vendimit për blerjen e kuotave në Fond, në mënyrë që të krijojë një ide të qartë për karakteristikat e Fondit dhe rreziqet e investimit në të.

Përmbajtje

I. TË DHËNA PËR FONDIN E HAPUR	4
1. INFORMACION I PËRGJITHSHEM PËR FONDIN E HAPUR	4
1.1 Fondi WVP Top Invest, Sipërmarrje Investimesh Kolektive me Ofertë Publike	4
1.2 Krijimi i Fondit dhe Kohëzgjatja.....	4
1.3 Shuma Minimale e Aseteve	5
2. OBJEKTIVAT E INVESTIMEVE, POLITIKAT E INVESTIMEVE DHE STRUKTURA E PLANIFIKUAR E PORTOFOLIT TË FONDIT TË HAPUR	6
2.1 Profili i Investitorit	6
2.2 Investimet e lejuara.....	6
2.3 Objektivat e Investimit dhe Struktura e Planifikuar e Portofolit.....	7
2.3.1 Objektivi i investimit	7
2.3.2 Struktura e planifikuar e portofolit.....	7
2.3.2 / 1 Benchmark i WVP Top Invest:	8
2.3.2 / 2 Shpërndarja e Aseteve të Fondit.....	8
2.3.3 Motivet për investim në Fond dhe Lloji i Investitorëve për të cilët është dedikuar Fondi	10
2.3.4 Të Dhëna Historike për të Ardhurat e Fondit.....	10
2.3.5 Parimet e Investimit të Aseteve.....	10
2.3.6 Metoda dhe Frekuenca e Vlerësimit të Aseteve të Fondit dhe Çmimit për Kuotë	11
3.1 Rreziku i tregut	12
3.2 Rreziku Operacional	13
3.3 Rreziku i Kredisë	13
3.4 Rreziku i Likuditetit.....	13
3.5 Rreziku i Kurseve të Këmbimit.....	13
3.6 Rreziku Rregullator	14
3.7 Rreziku i Inflacionit	14
3.8 Rreziku i Performancës.....	14
4. TË DREJTAT DHE DETYRIMET NGA KUOTAT NË FOND	15
5. PROÇEDURAT DHE KUSHTET PËR BLERJEN E KUOTAVE	15
6. PROÇEDURAT DHE KUSHTET PËR SHLYERJEN E KUOTAVE	17
7. PROÇEDURAT DHE KOHA E PAGESËS SË KUOTAVE GJATË SHLYERJES SË TYRE	17

8. RRETHANAT TË CILAT MUND TË COJNË NË PEZULLIMIN E LËSHIMIT DHE SHLYERJES SË KUOTAVE	18
9. MBYLLJA E FONDIT	18
9.1 Rrethanat e mbylljes.....	18
9.2 Kush e kryen procesin e mbylljes?.....	18
9.3 Likuiduesi, procedurat dhe afati kohor për mbylljen e fondit	19
10. TARIFAT	19
11. LLOJET E PLANEVE INVESTUESE	21
11.1 Pagesa e Njehershme	21
11.2 Plani i Programuar	22
11.3 Plani i Kombinuar	23
11.4 Plani Investim +	24
11.5 Përrjashtime nga Tarifa Hyrëse.....	24
11.6 Kostot për Transferte nga një Fond në Fondin Tjetër të Administruar nga Shoqëria.....	24
12. POLITIKA E SHPËRNDARJES SË FITIMEVE TË FONDIT DHE PJESËMARRJES NË FITIMET E FONDIT	25
13. MËNYRA DHE PROÇEDURA E INFORMIMIT TË MBAJTËSIT TË KUOTAVE	25
14. NJOFTIM PËR PERFORMANCËN DHE STRUKTURËN E FONDIT, SI DHE VENDI DHE MËNYRA E PUBLIKIMIT TË INFORMATAVE.	26
15. TRAJTIMI FISKAL I FONDIT DHE MBAJTËSIT TË KUOTAVE	27
16. KOHËZGJATJA E VITIT FISKAL.....	27
II. INFORMACIONE PËR SHOQËRINË E ADMINISTRIMIT TË FONDEVE	28
17. FORMA LIGJORE	28
18. DATA E THEMELIMIT TË SHOQËRISË	28
19. KAPITALI I SHOQËRISË, TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SHOQËRISË.....	28
20. ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE	29
20.1 Asambleja e aksionarëve	29
20.2 Këshilli i administrimit	29
21. INFORMACIONI MBI AKTIVITETET E SHOQËRISË.....	32
22. AUDITUESI	32
23. INFORMACIONE MBI DEPOZITARIN	32
III. INFORMACION PLOTËSUES	33

I. TË DHËNA PËR FONDIN E HAPUR

1. INFORMACION I PËRGGJITHSHEM PËR FONDIN E HAPUR

1.1 Fondi WVP Top Invest, Sipërmarrje Investimesh Kolektive me Ofertë Publike

Emri i fondit është: **WVP TOP INVEST – fond i hapur investimi;**

Emri i shkurtër i fondit është: **WVP TOP INVEST**

Fondi i investimit është një grupim i veçantë asetesh i paregjistruar si person juridik, i krijuar në bazë të një marrëdhënie kontraktuale, pas liçensimit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (në vijim: AMF) dhe i administruar nga një shoqëri administruese.

Kjo e fundit ka si veprimtari grumbullimin e asetëve monetare ose të ngjashme, nëpërmjet ofertës publike të kuotave në Fond, asetet e të cilit investohen sipas parimit të diversifikimit të rreziqeve në përputhje me ligjin nr.10198 “Mbi sipërmarrjet e investimeve kolektive”, datë 10.12.2009, dhe mbajtësit e kuotave të të cilit kanë të drejtën jo vetëm të marrin pjesë proporcionalisht në fitimet e Fondit, por gjithashtu të kërkojnë në çdo kohë shlyerjen e kuotave të tyre (në këtë mënyrë, kuotat anulohen).

Blerja e kuotave nëpërmjet një oferte publike kryhet nëpërmjet pagesës së asetëve monetare ku blerësi, pas blerjes së kuotave, hyn në një marrëdhënie ligjore me shoqërinë administruese, e cila është e detyruar të administrojë asetet e paguara si pjesë të asetëve kolektive, në përputhje me kushtet dhe kriteret e treguara në prospekt.

Mbajtësit e kuotave janë përgjegjës për detyrimet e fondit të investimit deri në shumën e pjesëmarrjes së tyre në fond.

Fondi i Investimit WVP TOP INVEST është një sipërmarrje investimesh kolektive (SIK) me ofertë publike, i themeluar nga WVP FUND MANAGEMENT TIRANA sh.a, shoqëri administruese e fondeve të investimit dhe SIK, e cila grumbullon asete monetare ose të ngjashme nëpërmjet ofertës publike të kuotave në Fond, dhe i administron ato me ndershmëri dhe profesionalizëm, në interesin më të mirë të investitorëve dhe të integritetit të tregut.

1.2 Krijimi i Fondit dhe Kohëzgjatja

Fondi u themelua me vendimin nr.14, datë 31.01.2018 të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Fondi është themeluar për një afat të pacaktuar.

Depozitari i Fondit është **First Investment Bank – Albania sh.a.**, me seli në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit”, TwinTowers, Kulla 2, Kati 14.

Ekspert Kontabël i Autorizuar i Fondit është GrantThornton sh.p.k, me seli në adresën: Rr. Sami Frashëri, Kompleksi T.I.D, Shk B, Kati 1, Tiranë, Shqipëri.

1.3 Shuma Minimale e Aseteve

Pas marrjes së miratimit për publikim të Prospektit të Fondit nga AMF-ja, Fondi do të fillojë me operacionet mbi grumbullimin e mjeteve në të holla me anë të thirrjes publike për blerjen e kuotave. Kuotat nisin të blihen dhe paguhen ditën e nesërme pas publikimit të Prospektit në gazetat e përditshme. Thirrja publike zgjat 30 ditë nga dita e shpalljes së Prospektit.

Çmimi fillestar i kuotës në ofertën fillestare do të jetë 1.000 LEK.

Në këtë periudhë kohore Fondi duhet të grumbullojë të holla, shumën minimale prej 250.000,00 euro në kundërvlerë të monedhes Lekë, sipas kursit mesatar të Bankës së Shqipërisë.

Oferta publike mund të përfundojë edhe para kalimit të afatit të lartpërmendur, nëse grumbullohet shuma minimale e mjeteve në të holla, domethënë oferta publike përfundon në ditën kur tërësisht është grumbulluar shuma minimale e parave.

Përfundimi i ofertes publike do të publikohet në faqen web të Shoqërisë. Pas përfundimit të ofertës publike, shitja dhe shlyerja e kuotave vazhdon nga moment i llogaritjes së vlerës neto të fondit të kuotave.

Në rast se nuk sigurohen paratë në nivelin e caktuar edhe në afatin e percaktuar në paragrafin (2) të këtij neni, depozitari (banka kujdestare) obligohet që në afat prej tetë (8) ditësh nga përfundimi i afatit të lartpërmendur t`ua kthejë investitorëve mjetet e grumbulluara.

2. OBJEKTIVAT E INVESTIMEVE, POLITIKAT E INVESTIMEVE DHE STRUKTURA E PLANIFIKUAR E PORTOFOLIT TË FONDIT TË HAPUR

Fondet e investimeve paraqesin mundësi për investimin e kapitalit, ku investitorët i besojnë asetet e tyre në të holla (paratë) institucioneve të specializuara – Shoqërive për administrimin me fondet investuese.

Asetet në të holla grumbullohen nëpërmjet shitjes së kuotave në Fond, ndërsa Shoqëria të njëjtat do t'i investojë në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit, Prospektit dhe Rregulloren e Fondit. Fondi është në pronësi të mbajtësve të kuotave. Mbajtësit e kuotave kanë të drejtë në pjesë proporcionale nga fitimet e fondit (kthim), si dhe kanë të drejtë në çdo moment të kërkojnë shlyerjen e kuotës dhe në atë mënyrë të dalin prej fondit.

2.1 Profili i Investitorit

Si investitorë të Fondit mund të paraqiten persona fizik të vendit dhe/ose të jashtëm, persona juridik të vendit dhe/ose të jashtëm, të cilët i konsiderojnë të përshtatshme objektivat e investimit të Fondit, synojnë një Fond likuid në çdo kohë dhe janë të përgatitur të marrin përsipër një shkallë të caktuar risku, kundrejt kthimeve të kënaqshme nga investimi.

2.2 Investimet e lejuara

Sipas ligjit nr.10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, portofoli i Fondit mund të përbëhet nga:

- tituj të transferueshëm dhe instrumente të tregut të parasë, që tregtohen në tregje të rregulluara ose në një bursë titujsh në Republikën e Shqipërisë, në një shtet të Bashkimit Europian apo në çdo shtet tjetër të lejuar nga AMF-ja;
- kuota të fondeve të investimit apo aksione të shoqërive të investimit, të liçencuara sipas ligjit nr.10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe nga kuota ose aksione të sipërmarrjeve kolektive të investimit, të liçencuara në përputhje me standardet e Bashkimit Europian;
- depozita në institucione kreditimi, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, në një nga shtetet anëtare të BE-së ose në çdo shtet të lejuar nga AMF-ja, të cilat mund të tërhiqen menjëherë ose që kanë afat maturimi jo më shumë së 12 muaj;
- instrumente financiare derivative
- instrumente të tjera të tregut të parasë.

Për secilin prej instrumenteve të mësipërm, shoqëria administruese angazhohet se do të respektojë kufizimet e investimit të parashikuara në Ligjin nr.10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe ato të parashikuara në politikën e brendshme për manaxhimin e rrezikut.

2.3 Objektivat e Investimit dhe Struktura e Planifikuar e Portofolit

2.3.1 Objektivi i investimit

Objektivi i investimeve të Fondit është realizimi i fitimeve për mbajtësit e kuotave të fondit, duke investuar në tituj të kompanive të mëdha “LargeCaps” në ekonomitë e zhvilluara botërore. Në këtë mënyrë mbajtësit e kuotave, në një afat më të gjatë kohor, do mund të marrin pjesë në rritjen e ekonomisë botërore dhe me atë të realizojnë një rritje të vlerës së kuotave në fond.

2.3.2 Struktura e planifikuar e portofolit

Objektivi i investimit do të arrihet nëpërmjet administrimit profesional të aseteve të fondit, kryesisht në krijimin e portofolit të titujve të tregjeve më të zhvilluara dhe më të rregulluara të botës.

Në fokus të politikës investuese të fondit do të jenë kompanitë e mëdha – “**Large Caps**” të cilat janë udhëheqës në industritë e tyre dhe kanë histori të vazhdueshme rritëse të pagesës së dividendit kundrejt investitorëve.

Në procesin e investimit kujdes i madh do t'i dedikohet minimizimit të rreziqeve, të cilat mund të hasen tek keto lloj investimesh.

Në procesin e administrimit të mjeteve të fondit do të zbatohet eksperiencia shumëvjeçare (mbi 30 vite) e WVP Group, posaçërisht politika e investimit të fondit të mbyllur të investimeve WVP Invest në Austri.

Mjetet e fondit do të investohen në tituj të emetuesve, të cilët tregëtohen në bursat e rregulluara në këto vende::

- a) **SHTETET E BASHKIMIT EUROPIAN**
- b) **SHBA – SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS**
- c) **ZVICRA dhe SHTETET E TJERA që janë pjesë të INDEKSIT STOXX EUROPE 50**

Shoqëria do t'i investojë mjetet e Fondit konform Ligjit për investimet e lejuara, kufizimin e investimeve dhe tejkalimin e kufizimeve për investime të aseteve së Fondit, në llojet e instrumenteve si vijon:

- **Aksione** – tituj e transferueshëm të cilat tregtohet në tregjet e rregullara të shteteve në pikat: a), b), dhe c).
- **Fondet e investimit** – kuota ose aksione të fondit të investimeve të regjistruara në shtetet e mësipërme në pikat: a), b), dhe c).
- **Depozitat** – depozitat nga bankat e autorizuara ne Republikën e Shqipërisë, në afat kohor jo më të gjatë se një vit;
- **Mjete monetare dhe ekuivalente (cash)**

Fondi mund të investojë vetëm në fonde investimi tarifa për administrim e të cilëve nuk tejkalon 2% nga vlera neto e aseteve të atij fondi në nivel vjetor. Deri më 100% të vlerës neto të Fondit mund të investohet në tituj / aksione të emetuesve veprimtaria e të cilëve, kryhet në territorin e vendeve të përmendura më lart.

Në tabelën që vijon është paraqitur struktura e planifikuar e portofolit të Fondit:

Lloji i instrumentit	Tregjet	Përqindje nga portofoli
Aksione - Tituj	Shtetet e përmendura në pikat: a), b), dhe c).	Deri më 100%
Fonde investimi		Deri më 50%
Asete depozitare në llogari me para	Republika e Shqipërisë	Deri më 75%

Në procesin e administrimit të aseteve do të shfrytëzohen strategjitë si vijon:

- **Value Investing** (strategji për investim në kompani të shëndosha dhe fitimprurëse);
- **Event Driven Strategy** (strategji e themeluar në ndodhi specifike globale);

2.3.2 / 1 Benchmark i WVP Top Invest:

Komiteti i Investimit ka vendosur benchmarkun për WVP Top Invest të jetë i kompozuar si më poshtë:

- 30 % Dow Jones Industrial Average Index
- 70 % Stoxx Europe 50 Index

2.3.2 / 2 Shpërndarja e Aseteve të Fondit

Në bazë të politikës investuese të aprovuar nga komiteti i investimit, konform kufizimeve dhe dispozitave të Ligjit si dhe për tu përshtatur Benchmarkut të vendosur nga Komiteti i Investimit, asetet e fondit do të kenë një diversifikim në Tregje, Valuta dhe Industri të ndryshme.

Shpërndarja e aseteve të WVP Top Invest mund të jetë si më poshtë:

- Deri më 30 % në tregjet e rregulluar të SHBA në valutën USD
- Mbi 50 % në tregjet e rregulluar në BE – në valutën EUR
- Deri më 10% në tregjet e rregulluara në Zvicër – në valutën CHF
- Deri më 10% në tregjet e rregulluara në Britaninë e Madhe – në valutën GBP
- Hapësirë prej 20 % në tregje dhe valuta të tjera të aprovuara nga AMF.

Shpërndarja sipas Industrive mund të jetë si vijon:

Industria:	Rreth %
Health Care / Shëndetsore	20
Financials / Financiare	20
Consumer Staples / Konsumit	15
Industrials / Industriale	15
Consumer Discretionary / Mallra/Shërbime luksi	12
IT / Teknologjia e Informacionit	15
Energy / Energjisë	10
Telecom / Telekomunikacion	5
Real Estate / Pronave të paluajtshme	5
Utilities / Utilitete	5
Materials / Prodhuese	10

KUIJDES: Shpërndarja e asetëve të Fondit nuk është fikse dhe ajo mund të hasë ndryshime në varësi të rrethanave ekonomike dhe politikës të investimit.

Investitorët duhet gjithmonë të kenë parasysh Sturkturën e planifikuar të Portofolit në tabelën e paraqitur në pikën 2.3.2.

Investimi i asetëve të Fondit do të jetë konform me dispozitat e nenit 87 dhe 88 të Ligjit.

Politika investuese e Fondit mund të ndryshohet me vendim të Shoqërisë me ndryshim dhe plotësim të Prospektit të Fondit, për të cilën do të informohen mbajtesit e kuotave të Fondit në mënyra të përshkruara në pikën 13 të këtij Prospekti, menjëherë pas miratimit të tyre, ndërsa para parashtrimit të kërkesës për miratim për ndryshim dhe plotësim ndaj AMF-së, kryesisht tekstit përfundimtar të Prospektit.

- **Investime në Instrumente Financiare Derivative**

Investimet në instrumente financiare derivative mund të përdoren si mjet për shmangien e rreziqeve dhe për arritjen e objektivave të Investimit të Fondit, por strategjia e investimit nuk do të ndryshojë për shkak të investimit në këto instrumente dhe ekspozimi ndaj rrezikut nuk mund të tejkalojë nivelet e parashikuara në ligjin nr.10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, apo në politikat e brendshme të shoqërisë administruese mbi investimet dhe administrimin e rrezikut.

2.3.3 Motivet për investim në Fond dhe Lloji i Investitorëve për të cilët është dedikuar Fondi

Fondi u dedikohet të gjithë atyre klientëve të cilët duan të realizojnë fitime duke shfrytëzuar rritjen globale në ekonominë botërore, posaçërisht në ekonomitë më të zhvilluara në botë si SHBA, Gjermani dhe Zvicër. Fitimet do të realizohen nëpërmjet investimit të aseteve të fondit në kompani të mëdha të cilat janë lëvizës të zhvillimit ekonomik dhe bartës të inovacioneve.

Nëpërmjet investimeve në fond klientët do të sigurojnë diversifikim të kapitalit të tyre dhe njëkohësisht do t'i realizojnë qëllimet e veta specifike financiare, me likuiditet të lartë të investimit.

Investitorët në fond mund të jenë persona fizikë dhe juridikë të vendit dhe të huaj, motivi i të cilëve është rritja e kapitalit me shfrytëzimin e:

- Zhvillimit të vazhdueshëm dhe inovacionit të korporatave të njohura botërore - kompanitë "LargeCaps", të cilat paguajnë dividend të lartë dhe të cilat edhe në periudha të aktivitetit të zvogëluar ekonomik arrijnë rezultate pozitive;
- Administrimit profesional të aseteve të fondit;
- Mundësisë për të zvogëluar rrezikun e tregut nga blerja direkte e aksioneve (investimit në bursa);
- Mundësisë që të bëhen aksionerë indirekt në kompanitë më të njohura botërore;
- Të ardhura të kënaqshme me rrezik mesatar;
- Ri-investimin automatik të fitimit (kthimit);
- Diversifikim të portofolit sipas vendeve, valutave dhe instrumentave;
- Mundësisë për ndjekje dhe qasje deri tek asetet e investuara në çdo moment;
- Ekspertizës dhe imazhit të cilin e ka ndërtuar Shoqëria për administrimin e fondeve.

Periudha kohore e cila është e preferueshme për investim në Fond është së paku 10 (dhjetë) vjet, por likuiditeti dhe fleksibiliteti ju është garantuar në çdo kohë.

Secili investitor potencial para nisjes së investimit do të duhet të përcaktojë objektivat e veta specifike financiare, të vlerësojë shkallën e pranueshme të rrezikut në të cilën mund të jetë i ekspozuar, të përcaktojë horizontin kohor të investimit dhe së fundi, të përcaktojë pritshmërinë e të ardhurave të cilat dëshiron të realizojë në të ardhmen. Asetet të cilat do të investohen rekomandohet që të jenë të lira dhe për qëllim diversifikimi. Zgjedhja e fondit duhet bërë bazuar në përshtatshmërinë me interesat dhe objektivat e parashtruara.

2.3.4 Të Dhëna Historike për të Ardhurat e Fondit

Nuk disponojmë një paraqitje historike të të ardhurave mesatare sipas kuotës duke pasur parasysh faktin se Fondi do të nisë të funksionojë vetëm pasi të jetë miratuar Prospekti.

Të ardhurat nga e kaluara kanë karakter informativ dhe nuk paraqesin tregues për të ardhurat e mundshme në të ardhmen.

2.3.5 Parimet e Investimit të Aseteve

Me qëllim që të realizojnë objektivat dhe politikat e përcaktuara, gjatë investimit të aseteve të Fondit, Shoqëria do të respektojë parimet në vijim:

- Transparencë;
- Likuiditet;
- Administrim profesional për të realizuar fitime;
- Diversifikim të rrezikut gjatë investimeve të aseteve të Fondit;
- Mbrojtje të interesave të investitorëve;
- Besueshmëri dhe fshehtësi të të dhënave;
- Paanshmëri, neutralitet, ndërgjegjshmëri dhe profesionalitet;
- Veprim të kujdesshëm të një afaristi të mirë.

2.3.6 Metoda dhe Frekuenca e Vlerësimit të Aseteve të Fondit dhe Çmimit për Kuotë

Shoqëria administruese llogarit vlerën totale të aseteve të Fondit, përcakton detyrimet e tij dhe llogarit vlerën neto të aseteve të Fondit si edhe vlerën neto të aseteve për kuotë. **Këto llogaritje bëhen në bazë ditore.**

Depozitari garanton që llogaritja e vlerës neto të kuotave në Fond është shpallur në përputhje me ligjin, rregulloret përkatëse të AMF-së, prospektin dhe rregullat e Fondit;

Metoda e vlerësimit të aseteve dhe detyrimeve financiare të Fondit bazohet në dispozitat e Ligjit nr.10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” dhe rregulloren “Mbi përcaktimin e vlerës së aseteve të sipërmarrjeve të investimit kolektiv dhe llogaritjen e vlerës neto të aseteve të tyre për kuotë ose për aksion” e dale në zbatim të tij, si edhe në parimet e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Vlera e kuotës së Fondit në ditën e vlerësimit përcaktohet duke pjesëtuar vlerën neto të aseteve të Fondit në LEKË, me numrin e përgjithshëm të kuotave për atë ditë. Ky numër përputhet me numrin e kuotave në ditën paraardhëse të vlerësimit duke i zbritur numrin e kuotave të shlyera në ditën e vlerësimit dhe duke i shtuar numrin e kuotave që Fondi ka emetuar, në ditën e vlerësimit.

Dita e vlerësimit të aseteve të Fondit (t-1) do të jetë një ditë para ditës (t) gjatë së cilës është llogaritur vlera neto e aseteve për kuotë.

Depozitari ka detyrimin që të informojë Autoritetin në lidhje me përlllogaritjen e vlerës neto të aseteve të Fondit dhe çmimit për kuotë në çdo ditë të vlerësimit (t), dhe jo më vonë se ora 14:00 e së të njëjtës ditë.

3. RREZIQET KRYESORE TË INVESTIMIT NË FOND

Investimi në Fondin WVP Top Invest i jep investitorit mundësi përfitimi por në të njëjtën kohë shoqërohet me rrezikun e sipërmarrësit.

Është e pamundur që rreziku të shmanget plotësisht, por ai mund të reduktohet duke zbatuar procedurat e duhura për administrimin e tij. Për këtë qëllim, shoqëria administruese ka në strukturën e saj organizative një njësi të veçantë, përgjegjëse për kontrollin e të gjitha transaksioneve që kryhen në emër të Fondit. Veprimtaria e kësaj njësie së bashku me metodologjinë e administrimit të rrezikut janë të parashikuara në rregulloret dhe procedurat e brendshme të shoqërisë administruese.

Në momentin e vendimarrjes për investime, shoqëria administruese trajton çdo investim të veçantë brenda kuadrit të rrezikut të përgjithshëm që rezulton nga totali i asetëve të Fondit, duke zbatuar parimet e sigurisë, likuiditetit dhe përfitueshmërisë.

FONDI MUND TË MOS JETË NJË INVESTIM I PËRSHTATSHMËRINË PËR TË GJITHË INVESTITORËT.

Çdo investitor potencial në Fond duhet të gjykojë mbi përshtatshmërinë e investimit në funksion të kushteve dhe nevojave të tij specifike. Në veçanti, çdo investitor potencial duhet:

- Të ketë njohuri dhe përvojë të mjaftueshme për të bërë një vlerësim të saktë të Fondit, të perfitimeve dhe rreziqeve nga investimi në Fond, si edhe të informacionit që përmban ky prospekt dhe çdo dokument tjetër që lidhet me Fondin; Të ketë njohuri për të vlerësuar siç duhet investimin në Fond, në përputhje me situatën e tij financiare, dhe ndikimin që Fondi do të ketë mbi totalin e portofolit të tij të investimeve;
- Të ketë likuiditet të mjaftueshëm dhe burime të tjera financiare për të përballuar të gjitha rreziqet që mund të vijnë nga investimi në Fond;
- Të kuptojë plotësisht kushtet e Fondit dhe funksionimin e tregjeve financiare; dhe
- Të jetë në gjendje të vlerësojë skenarë të mundshëm që lidhen me faktorë ekonomikë apo të tjerë, të cilët mund të ndikojnë në investimet e tij dhe në shkallën e rrezikut të marrë përsipër.

Fondi është i përshtatshëm për investitorët të cilët kanë një tolerancë mesatare ndaj rrezikut; megjithatë performanca e Fondit mund të çenohet në veçanti nga rreziqet e mëposhtme:

3.1 Rreziku i tregut

Është rreziku i luhatshmërisë të çmimit të titujve në treg. Bazuar në strategjinë e investimit të parashikuar në këtë prospekt, asetet e Fondit do të investohen në instrumente financiare, të cilët janë lirisht të tregtueshëm dhe çmimi i të cilave mund të ndryshojë çdo ditë. Ulja e çmimit të titujve mund të sjellë uljen e vlerës së portofolit të Fondit si dhe vlerën e fitimeve të realizuara dhe e kundërta, rritja e çmimit të titujve mund të sjellë rritjen e vlerës së portofolit të Fondit si dhe rritjen e fitimeve nga ai.

Me qëllim mbrojtjen nga rreziku i tregut dhe minimizimin e tij, Shoqëria do të operojë nëpërmjet diversifikimit të portofolit, konform me parimin e shpërndarjes së rrezikut.

3.2 Rreziku Operacional

Ky është rreziku i humbjeve të Fondit të shkaktuara nga gabime njëzore ose të sistemeve brenda shoqërisë administruese, nga ekzistenca e proceseve të brendshme të papërshtatshme, nga gabime ligjore ose të dokumentacionit, si dhe nga procedurat e tregëtimit, të vlerësimit dhe pagesave në emër të Fondit.

3.3 Rreziku i Kredisë

Rreziku i kredisë paraqet mundësinë se emetuesi i ndonjë titulli të caktuar të mos jetë në gjendje të shlyejë pjesërisht ose plotësisht të gjitha detyrimet e tij në momentin kur ato do të duhet të plotësohen. Mos plotësimi i detyrimeve nga ana e emetuesit të titujve do të kishte impakt negativ mbi vlerën e aseteve të Fondit.

Edhe kur instrumentat e investimit zgjidhen me kujdesin dhe përgjegjshmërinë e duhur, është e pamundur që rreziku i kredisë të përjashtohet plotësisht. Shoqëria do të minimizojë këtë rrezik duke mos përfshirë në portofolin e vet tituj borxhesh.

3.4 Rreziku i Likuiditetit

Ky rrezik lidhet me mundësinë që një aset financiar të mos shitet shpejt dhe me një çmim të përafërt me vlerën e tregut. Pavarësisht objektivit të Fondit për të krijuar një portofol të përbërë kryesisht nga tituj që kanë një treg sekondar aktiv, shitja e një titulli të caktuar, në momentin e kërkuar, mund të bëhet problematike.

Shoqëria do të manaxhojë rrezikun e likuiditetit nëpërmjet investimeve në tituj likuidë të tregtuara në bursat me likuiditet të lartë.

3.5 Rreziku i Kurseve të Këmbimit

Rreziku nga kurset e këmbimit paraqet një formë të rrezikut i cili paraqitet gjatë ndryshimit të çmimit të një valute në raport me tjetrën. Fondi në portofolin e vet zotëron tituj të vlerësuar në valuta të ndryshme dhe ndryshimet e mundshme të këtyre valutave në raport me valutën e vendit mund të çojnë deri tek rritja ose zvogëlimi i vlerës së kuotave. Këtë rrezik Shoqëria do ta reduktojë me shpërndarjen e portofolit në valuta të huaja të ndryshme, duke tentuar të uli lëvizjet e mëdha të valutave botërore.

KUJDES: Fondi WVP Top Invest është në LEK dhe çdo ndryshim valutor në bazë ditore mund të çojë deri tek zvogëlimi ose rritja e vlerës së kuotave.

Kursi valutor në LEK merret nga kursi mesatar i Bankës së Shqipërisë.

3.6 Rreziku Rregullator

Rreziku rregullator lidhet me mundësinë e ndryshimeve të kuadrit rregullator, përfshirë legjislacionin tatimor. Vlera e aseteve të Fondit mund të ndikohet negativisht nga: ndryshimet e legjislacionit që rregullon fondet e investimeve, nga ana e autoritetit rregullues, nga shfaqja e pasigurive në vendet ku janë bërë investimet, të tilla si tendencat politike kombetare dhe ndërkombëtare, ndryshime në politikat e qeverisë, ndryshime në legjislacionin tatimor etj.

3.7 Rreziku i Inflacionit

I quajtur ndryshe rreziku i fuqisë blerëse, ky është rreziku që ndryshimet në të ardhurat reale të një investitori pasi i ka përshtatur ato me nivelin e inflacionit të jenë negative.

Ky rrezik tregon se norma e inflacionit tejkalon normën e kthimit nga investimi. Si rrjedhim, investitori mund të pësojë realisht humbje edhe pse ai/ajo mund të ketë patur fitim në terma absolutë.

3.8 Rreziku i Performancës

Performanca e Fondit mund të devijojë nga pritshmëritë dhe një performancë pozitive nuk mund të garantohet nga shoqëria administruese.

Shënim i rëndësishëm: Çdo investim në Fond, nuk konsiderohet si depozitë bankare, dhe si i tillë nuk sigurohet nga Agjensia e Sigurimit të Depozitave!

Megjithëse Fondi synon ruajtjen e kapitalit, ekziston mundësia e humbjes nga investimi në Fond.

4. TË DREJTAT DHE DETYRIMET NGA KUOTAT NË FOND

Në momentin e blerjes të kuotave në fond, çdo investitori do ti lëshohet nëpërmjet postës elektronike Çertifikata për kryerjen e transaksionit e cila vërteton pronësinë mbi kuotat.

Ajo përmban: datën e blerjes së kuotave, emërtimin e fondit, emrin dhe selinë e regjistruar të shoqërisë administruese, numrin e kuotave të blera, emrin dhe mbiemrin e mbajtësit të kuotave, vendin dhe datën e lëshimit të çertifikatës, si dhe kredencialet për të hyrë në profilin personal të investitorit në sistemin online të shoqërisë.

Çertifikata lëshohet nëpërmjet dërgesës postare vetëm në rast të kërkesës nga Investitori brenda 7 ditëve kalendarike nga data e mbërritjes së kërkesës.

Të drejtat që lidhen me pronësinë e kuotave në Fond janë:

- E drejta për informacion (raporte vjetore, gjashtë mujore etj) ;
- E drejta për të marrë pjesë në fitimet e Fondit, proporcionalisht me pjesëmarrjen në të ;
- E drejta për të shitur kuotat në çdo kohë ;
- E drejta që asetet e Fondit, në rast falimenti të shoqërisë administruese ose të depozitarit, të jenë objekt i së drejtës së ndarjes.

Këto asete nuk do të përfshihen në asetet e shoqërisë administruese ose të depozitarit gjatë procedurave të likuidimit ose të falimentimit, dhe as për zbatimin e pretendimeve ndaj tyre. Në lidhje me detyrimet që lindin nga kuotat, mbajtësit e kuotave janë përgjegjës për detyrimet e Fondit deri në shumën e pjesëmarrjes së tyre në fond.

5. PROÇEDURAT DHE KUSHTET PËR BLERJEN E KUOTAVE

Shoqëria për administrimin e fondeve investuese, pas paisjes me leje nga AMF-ja për themelimin e Fondit lëshon kuotat në Fond.

Me plotësimin e Formularit KËRKESË PËR BLERJE KUOTASH në WVP Top Invest (në tekstin në vijim: Kërkesa) çdo person fizik ose juridik mund të blejë kuota në Fond. Kërkesa për blerje plotësohet në formular të veçantë të përgatitur nga Shoqëria.

Formularët mund të merren dhe plotësohen çdo ditë pune në zyrat e Shoqërisë ose jashtë saj nëpërmjet personave të autorizuar për shitjen e kuotave dhe në webfaqen e Shoqërisë www.wvpfunds.al .

Së bashku me dorëzimin e Kërkesës për blerje, pala – person fizik duhet të dorëzojë edhe një dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë).

Gjatë dorëzimit të Kërkesës për blerje, pala – person juridik, duhet të dorëzojë dokumentacionin në përputhje me rregullat ligjore , si Ekstrat nga QKR ose dokument tjetër i lëshuar nga organet kompetente dhe kartë identiteti të përfaqësuesit ligjor të personit juridik.

Në qoftë se gjatë Kërkesës për blerje, pala, person fizik ose juridik, paraqitet nëpërmjet të autorizuarit, bashkangjitur me Kërkesën për blerje do të bashkangjisë edhe kopje të autorizimit të vërtetuar në noter (prokurë) e cila duhet të theksojë se autorizimi ka të bëjë me blerje të kuotave.

Në raste të caktuara specifike (kur pala është e mitur ose përon të cilit i është kufizuar pjesërisht ose tërësisht zotësia e veprimit), Kërkesën për blerje të kuotave e dorëzon përfaqësuesi ligjor (prindi, kujdestari, adoptuesi) i personit të mitur ose personit të cilit pjesërisht ose tërësisht i është kufizuar zotësia e veprimit.

Të dhënat personale grumbullohen, përpunohen dhe përdoren nga ana e Shoqërisë, vetëm konform objektivave të përcaktuara me Ligj, Prospektin dhe Rregulloren e Fondit, si dhe në përputhje me Ligjin dhe rregullat për mbrojtje të të dhënave personale.

Blerja e kuotave në Fond kryhet vetëm nëpërmjet pagesës së aseteve monetare ku blerësi, pas blerjes së kuotave, hyn në një marrëdhënie ligjore me shoqërinë administruese, e cila është e detyruar të administrojë asetet e paguara si pjesë të aseteve kolektive, në përputhje me kushtet dhe kriteret e treguara në prospekt.

Në rrethana të veçanta, të përcaktuara nga AMF-ja, blerja e kuotave në Fond mund të bëhet edhe në tituj apo asete të tjera, me kushtin që titujt apo asetet e tjera të jenë të tregtuara në tregje të organizuara ose të rregulluara, ku është i mundur të përcaktohet çmimi i tyre i saktë.

Çdo pagesë për blerje kuotash kryhet në llogarinë bankare të Fondit me nr. **AL18 2151 1031 ALL1 0000 1128 2800**, të hapur pranë depozitarit, i cili është FirstInvestmentBank - Albania, sh.a në një nga mënyrat e mëposhtme:

- Pagesë cash direkt në sportelet e Bankës FirstInvestmentBank – Albania, sh.a;
- Transfertë nga llogaria e investitorit pranë çdo banke të nivelit të dytë drejt llogarisë së Fondit.

Ky transaksion është subjekt i komisioneve bankare për transfertat të aplikuara si nga Banka ku investitori ka llogarinë ashtu edhe nga Banka Depozitare.

Çdo investitor që dëshiron të blejë kuota në Fond, do të nënshkruajë një kërkesë blerjeje dhe do të bëhet mbajtësi një numri të caktuar kuotash në momentin që kryen pagesën në favor të llogarisë së Fondit. Çmimi i blerjes së kuotës do të jetë çmimi i zbatueshëm në ditën e kryerjes së pagesës në Fond, i llogaritur në përputhje me ligjin nr.10198, datë 10.12.2009 « Për sipërmarrjet e investimeve kolektive », rregulloret në zbatim të tij, si dhe në përputhje me këtë prospekt.

Numri i kuotave në Fond përcaktohet me 4 shifra pas presjes dhjetore.

Në rastet kur investitori nuk jep informacionin e duhur, në përputhje me rregulloret e brendshme ose ligjet përkatëse, ose kur ai paraqet një informacion të rremë, WVP Fund Management Tirana ka të drejtë të refuzojë kërkesën (urdhërin) për blerjen e kuotave, plotësisht ose pjesërisht.

Në qoftë se investitori paratë për blerjen e kuotave i paguan gjatë ditës (t) deri në orën 24:00, atëherë ai blen kuota sipas vlerës së kuotës në ditën (t) me vlerë të panjohur. Për pagesat e bëra pas orës 24:00, kuotat blihen sipas vlerës së kuotës individuale të ditës tjetër (t+1), gjithashtu me vlerë të panjohur.

Vërtetimin për blerjen dhe gjendjen e kuotave, pa marrë parasysh se si janë fituar lëshohet nga ana e Shoqërisë, me kërkesë të investitorit jo më vonë se 5 ditë nga kryerja e pagesës në Fond. Për kuotat e lëshuara mbahet evidencë në formë elektronike në Shoqërinë dhe në bankën depozitare.

6. PROÇEDURAT DHE KUSHTET PËR SHLYERJEN E KUOTAVE

Secili pronar i kuotave të Fondit ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e një numri të caktuar ose të gjithë kuotave të cilat ai zotëron dhe në këtë mënyrë të dalë nga Fondi.

Vlera e çdo kuote shlyhet pa komision.

Mbajtësit e kuotave në çdo kohë mund të parashtrajnë Kërkesë për shlyerjen e të gjithë kuotave ose një pjesë të tyre. Kërkesa për shlyerjen e kuotave plotësohet nëpërmjet një formulari të veçantë të përgatitur nga Shoqëria, ku mund të merret në zyrat e Shoqërisë, në webfaqen e Shoqërisë www.wvpfunds.al si dhe nëpërmjet rrjetit shitës të krijuar nëpërmjet agjenteve shitës.

Gjatë dorëzimit të kërkesës për shlyerje, pala detyrimisht legjitimohet nëpërmjet dokumentacionit përkatës. Personat fizikë legjitimohen nëpërmjet dokumentit për identifikim personal (kartë identiteti ose pasaportë). Në qoftë se bëhet fjalë për person juridik, legjitimimi bëhet me dorëzimin e dokumentacionit përkatës (ekstrakt nga QKR, Fotokopje Nipt-i) si dhe kartën e identitetit të përfaqësuesit ligjor të personit juridik.

Shlyerja e kuotave bëhet sipas çmimit të vlerës së kuotave të përcaktuara ditën pasardhëse të vlerësimit (t+1) pas dorëzimit të Kërkesës për shlyerje të kuotave (në tekstin në vijim: Kërkesë për shlyerje). Në qoftë se kërkesa për shlyerje është parashtruar pas orës 14:00 ditën rrjedhëse, e njëjti do të llogaritet se është pranuar ditën e ardhshme.

Vërtetimin për shlyerjen e kuotave lëshohet nga ana e Shoqërisë, me kërkesë të investitorit jo më vonë se 5 ditë nga kryerja e pagesës në Fond.

Për kuotat e shlyera mbahet evidencë në formë elektronike në Shoqërinë dhe në bankën depozitare.

Në çdo rast e ardhura nga investimi do të jetë subjekt i tatimit sipas dispozitave të Ligjit nr.8438, date 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar.

7. PROÇEDURAT DHE KOHA E PAGESËS SË KUOTAVE GJATË SHLYERJES SË TYRE

Në bazë të Kërkesës së parashtruar për shlyerje nga ana e mbajtësit të kuotave, Shoqëria jep urdhër deri tek banka depozitare, e cila kryen pagesën e vlerës së përcaktuar në llogarinë bankare të mbajtësit të kuotave, te përcaktuar në formularin e Kërkesës për shlyerje.

Shoqëria është e detyruar që të kryejë pagesën e për kuotat e shlyera nga Fondi jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pas pranimit të Kërkesës për shlyerje.

8. RRETHANAT TË CILAT MUND TË COJNË NË PEZULLIMIN E LËSHIMIT DHE SHLYERJES SË KUOTAVE

Shlyerja e kuotave të Fondit mund të pezullohet në rastet kur:

- Shoqëria administruese dhe depozitari vlerësojnë se në bazë të rrethanave të jashtëzakonshme nuk është i mundur të përcaktohet çmimi i saktë i asetëve në portofolin e fondit dhe se ka arsye të forta e të justifikuar, për pezullimin e shlyerjes, në interes të mbajtësve të kuotave.
- Çdo pezullim i shlyerjes do të njoftohet menjëherë në AMF dhe do të publikohet në një gazetë të përditshme, me qarkullim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Megjithatë AMF-ja mund të urdhërojë shlyerjen e kuotave të Fondit, nëse kjo është në interes të publikut ose në interes të investitorëve në Fond.
- AMF-ja, në mënyrë të arsyeshme, vlerëson se investitorëve u është shkaktuar dëm, për shkak të llogaritjes së pasaktë të çmimit të kuotave të fondit. Ajo udhëzon shoqërinë administruese dhe depozitarin për të pezulluar përkohësisht shitjen dhe shlyerjen e kuotave.

Pezullimi i shlyerjes së kuotave duhet të mbarojë jo më vonë se 28 ditë nga fillimi i pezullimit , përveçse nëse AMF-ja jep miratimin me shkrim për zgjatjen e kufirit të dhënë kohor. Rifillimi i veprimtarisë tregtare të Fondit publikohet në një gazetë të përditshme, në qarkullim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

9. MBYLLJA E FONDIT

9.1 Rrethanat e mbylljes

Shoqëria administruese mund të iniciojë mbylljen e Fondit, kur krijohen rrethanat e parashikuara në ligjin nr.10198, datë 10.12.2009 « Për sipërmarrjet investimeve kolektive » dhe në mënyrë të veçantë kur:

- ajo mbyll vullnetarisht aktivitetin e saj;
- i nënshtrohet procedurave të falimentimit dhe likuidimit si pasojë e mospërbushjes së detyrimeve;
- AMF-ja i ka hequr përkohësisht ose në mënyrë të përhershme licensën.

9.2 Kush e kryen procesin e mbylljes?

Mbyllja e Fondit të investimit realizohet nga shoqëria administruese që administron Fondin.

Në rastet kur kjo shoqëri i është nënshtrohet procedurave të falimentimit ose kur AMF-ja ka pezulluar përkohësisht ose ka hequr në mënyrë të përhershme licencën e saj, atëherë mbyllja realizohet nga depozitari i Fondit.

Nëse depozitari është duke ju nënshtrohet procedurave të falimentimit ose kur licenca e tij si depozitar apo si bankë është pezulluar përkohësisht apo është hequr në mënyrë të përhershme, mbyllja e Fondit do të realizohet nga një likuidues fondi, i caktuar nga AMF-ja.

9.3 Likuiduesi, procedurat dhe afati kohor për mbylljen e fondit

Brenda 7 ditëve nga data e marrjes së vendimit, likuiduesi është i detyruar të informojë AMF-në dhe të gjithë investitorët e Fondit për mbylljen e Fondit.

Pas marrjes së vendimit për mbyllje, çdo shitje e mëtejshme ose shlyerje e kuotave në Fondin e investimit është e ndaluar, përveçse në rastet e kërkesave të marra pas përcaktimit më të fundit të çmimit dhe para marrjes së vendimit për mbyllje.

Nga data e marrjes së vendimit për mbyllje, nuk ngarkohet asnjë tarifë mbi Fondin.

Likuiduesi është i detyruar t'i paraqesë AMF-së raportet për ecurinë dhe raporte përfundimtare të mbylljes, si dhe është përgjegjës për përgatitjen e raporteve të kërkuara.

Gjatë procedurës së mbylljes, veprimtaria e biznesit në vijim do të ndërpritet. Transaksionet me asetet e Fondit do të lejohen vetëm për qëllimet e mbylljes së Fondit. Në këtë mënyrë, shiten të gjitha asetet e Fondit, si dhe paguhen detyrimet e tij, të kërkueshme deri në datën e marrjes së vendimit për mbyllje. Pjesa e mbetur e vlerës neto të aseteve të Fondit u shpërndahet mbajtësve të kuotave në përpjesëtim me pjesën e tyre në Fond.

Afati kohor për të realizuar mbylljen e një Fondi investimi do të jetë deri në 6 (gjashtë) muaj nga data e marrjes së vendimit për mbylljen e Fondit. Por në rastin kur likuiduesi vendos që është në interesin e kreditorëve dhe mbajtësve të kuotave për të shtyrë këtë afat, Autoriteti mund të miratojë shtyrjen e afatit kohor për realizimin e procedurave të mbylljes edhe për maksimumi 6 muaj të tjerë.

10. TARIFAT

TARIFAT DHE KOSTOT QË LIDHEN ME FONDIN E INVESTIMIT

Tarifat që do t'u ngarkohen mbajtësve të kuotave në Fondin WVP Top Invest janë:

- a) Tarifa e hyrjes;
- b) Tarifa për administrimin e Fondit;
- c) Tarifat dhe kostot, që i paguhen depozitarit;
- d) Kostot, komisionet ose shpërblimet për shitblerjen e aseteve;
- e) Kosto të tjera operationale.

a. Tarifa e Hyrjes

Tarifa e hyrjes është kosto që investitori e paguan gjatë investimit të aseteve në Fond, më qëllim të blerjes së kuotave dhe i njejta vlere i zbritet nga shuma e investimit të parë.

Tarifa e hyrjes do të përcaktohet sipas shkallës të paraqitur në tabelën në vijin:

Shuma (EUR)	Tarifa e hyrjes (%)
Deri 14.999	5%
15.000-24.999	4,5%
25.000-49.999	4%
50.000-99.999	3,5%
100.000-249.999	3%
250.000-499.999	2,5%
500.000-999.999	2%
1.000.000-2.499.999	1,5%
Mbi 2.500.000	1%

Shuma (LEK)	Tarifa e hyrjes (%)
Deri 2.035.000	5%
2.035.001 - 3.400.000	4,5%
3.400.001 - 6.800.000	4%
6.800.001 - 13.600.000	3,5%
13.600.01 - 34.000.000	3%
34.000.001- 68.000.000	2,5%
68.000.001- 136.000.000	2%
136.000.001-340.000.000	1,5%
Mbi 340.000.000	1%

Të dhënat ne Tabelën me EURO dhe në të gjitha rastet tjera ku EURO merret si monedhë janë të paraqitura vetëm për kalkulim më të lehtë dhe kanë karakter informativ.

Tarifa e hyrjes nuk do të paguhet në rastet kur klienti bën shlyerjen e pjeshme ose të plotë të kuotave, mirëpo në afat prej 12 muajsh përsëri e investon shumën të cilën i është paguar me shlyerjen.

Në rast kur klienti investon konform mënyrës së pagesës të përcaktuar në ndonjë nga planet (detajisht të sqaruar në pikën 11.1, 11.2, 11.3 dhe 11.4), pas shlyerjes së bërë, në një afat prej 12 muajsh duhet të paguajë shumën e shlyer duke i shtuar edhe pagesën e rregullt.

Në rastin kur klienti ka asete në fond, për pagesat e ardhshme përqindja e tarifës së hyrjes do të përcaktohet duke mbledhur shumën e planit ekzistues me planin e ri investues.

Planet e pagesave më detajisht janë të sqaruara më poshtë në pikën 11.1, 11.2, 11.3 dhe 11.4.

Në rast se Investitori bën kërkesë për mbartjen e kuotave, nga një fond ne nje fond tjetër të administruar nga Shoqëria, atëhere nuk do të bëhet ndërprerja e planit ekzistues.

b. Tarifa për Administrimin e Fondit

Tarifat që do t'u ngarkohen mbajtësve të kuotave në Fond do të jetë 2% në vit e vlerës neto të aseteve të Fondit.

Tarifa për administrimin e fondit llogaritet çdo ditë në bazë të vlerës neto të Fondit sipas formulës në vijim:

$$2\% / 365$$

c. Tarifat dhe Kostot, që i Paguhet Depozitarit

Shoqëria në llogari të pronës së Fondit arkëton tarifën dhe kostot e bankës depozitare për punët të cilat janë përcaktuar në kontratën me bankën depozitare, Ligjin, Rregulloren dhe Tarifën për kostot dhe shpenzimet për kryerjen e punës së bankës depozitare.

Gjithashtu, në llogari të pronës së Fondit, Shoqëria i paguan bankës depozitare kostot për bankën nën-depozitare. Shuma e këtyre kostove është e barabartë me kostot reale.

d. Kostot, Komisionet ose Shpërblimet për Shitblerjen e Aseteve

Këto kosto i përmbajnë të gjitha kostot e lidhura me blerjen dhe shitjen e pronës së fondit p.sh.: kostot për komisionet brokere, tarifat e bursës, tarifa për Depozitarin qëndror të titujve, tatime dhe kosto të tjera të mundshme të lidhura me barazimin e transaksioneve. Shuma e këtyre kostove është në nivel të kostove reale që dalin nga kontratat, referuar listave të tarifave të institucioneve përkatëse dhe të njejtat bien në llogari të Fondit. Kostot për blerjen dhe shitjen dallojnë në varësi të tipit të titujve.

e. Kosto të Tjera Operacionale

Kostot e tjera që do të dalin gjatë veprimtarisë dhe mund të regjistrohen drejtpërdrejt duke debituar mbajtësit e kuotave janë si më poshtë:

- Kostot për auditim vjetor;
- kostot e përgatitjes, të shtypjes dhe tarifat postare për raportet gjashtëmujore dhe vjetore për mbajtësit e kuotave;
- taksat, që paguhen nga fondi për asetet ose fitimin e tij;
- të gjitha tarifat dhe shpërblimet e parashikuara, që i paguhen AMF-së..

Këto kosto paraqesin kostot që do të dalin gjatë veprimtarisë së Fondit dhe mund të paguhen në llogari të pronës së Fondit në vlerën e kostove reale që dalin nga kontratat, referuar listave të tarifave të institucioneve relevante.

Shpenzimet totale te fondit te investimit nuk do të tejkalojnë totalen e 3 % të vlerës neto të asetëve të fondit (NAV).

Shoqëria nuk do të aplikoje tarifë për shlyerjen e kuotave.

11. LLOJET E PLANEVE INVESTUESE

11.1 PAGESA E NJËHERSHME

Kur investitori do të vendosë të bëjë një investim të njëhershëm në Fond, tarifa e hyrjes do të përcaktohet sipas tabelës në piken 10.a si më lartë.

Shuma minimale për blerjen e kuotave nëpërmjet investimit të njëhershëm është 250.000 LEK.

Tarifa e hyrjes llogaritet në zbatim të formulës në vijim:

$$\text{Tarifa e hyrjes} = \text{shuma totale e investimit} * \text{tarifa e hyrjes (\%)}$$

Shembull: Në qoftë se një person investon 15.000 euro si investim të vetëm, sipas tabelës tarifa e hyrjes do të jetë 4,5% nga investimi, përkatësisht 675 euro.

11.2 Plani i Programuar

Investitorët mund ta zgjedhin Planin e programuar të pagesave, dmth të investojnë mbi bazë të pagesave të barabarta vjetore, gjashtë mujore, tremujore dhe mujore. Plani i programuar lidhet me afatin kohor prej minimumi 10 vjet deri në maksimumi 30 vjet. Shuma minimale e pagesës vjetore është 35.000 LEK (250 Euro).

Investitorët gjatë pagesës së parë (këstit të parë vjetor) preferohet të paguajnë shumën e 2 (dy) kësteve vjetore nga Plani i programuar.

Në rast kur investitori do të vendosë që pagesa vjetore të jetë më e madhe se 3.500 euro, plani i programuar mund të fillojë me pagesën e një kësti të vetëm për 1 vit.

Pagesat vjetore të përmendura mund të paguhen edhe në këste mujore, tremujore ose në 6 mujore.

Gjatë krijimit të Planit të programuar, investitori mund të përfitojë tarifë hyrje më të favorshme në raport me pagesat e njehershme, në varësi të shumës totale të planit investues. Përqindja e tarifës hyrëse përcaktohet konform tabelës për tarifën hyrëse në pikën 10.a.

Tarifa hyrëse është pjesë e pagesës së parë dhe zbatohet sipas formulës në vijim:

$$\text{Tarifa hyrëse} = \text{shuma totale e planit investues} * \text{tarifa e hyrjes (\%)}$$

Shembull: Investitori i cili do të vendosë të investojë 26.000euro në periudhë prej 25 vitesh me pagesa të barabarta vjetore nga 1.000, tarifa e hyrjes do të jetë 1.040,00 euro. Pagesa e parë duhet të jetë një minimum prej 2.000 euro.

Kërkesa për blerje, tek Plani i programuar dorëzohet vetëm një herë, gjatë pagesës së parë të aseteve për aktivizimin e planit.

Plani i programuar përfundon kur Investitori do të paguajë në total të gjithë shumën e parashikuar në planin investues ose kur do të kalojë periodha kohore për të cilën është lidhur.

Në rast të ndërprerjes së planit, investitori nuk ka të drejtë të kërkojë kthim të tarifës hyrëse të paguar ose të shfrytëzojë shkallën e përfitimit të tarifës hyrëse gjatë pagesës së ardhshme në fond.

11.3 Plani i Kombinuar

Plani i kombinuar paraqet planin e veçantë i cili mundëson kombinim të pagesës së njëhershme dhe të planit të kombinuar. Plani lidhet për një periudhë kohore prej minimum 10 vjet deri në maksimumi 30 vjet. Plani përbëhet nga pagesa e njëhershme dhe më tej vazhdon me pagesa te barabarta vjetore sipas intervalit te pagesave. Shuma minimale e pagesës vjetore është 35.000 LEK (250 Euro).

Pagesa e njëhershme me të cilën aktivizohet plani i kombinuar duhet të jetë më i madh ose i barabartë me (3) tre pagesa vjetore.

Tarifa e hyrjes është pjesë nga pagesa e njëhershme dhe do të përcaktohet si shuma totale e pagesave të barabarta vjetore dhe pagesës së njëhershme, sipas tabelës për tarifën hyrëse në pikën 10.a.

Tarifa hyrëse është pjesë e pagesës së parë dhe zbatohet sipas formulës në vijim:

$$\text{Tarifa hyrëse} = \text{shuma totale e planit investues} * \text{tarifa e hyrjes (\%)}$$

Pagesat e ardhshme mund të paguhen edhe në këste mujore, tre mujore ose në gjashtë mujore.

Shembull: Investitori i cili do të vendosë të investojë në start pagesë të njëhershme prej 10.000 euro dhe në periudhë prej 20 vitesh pagesa vjetore të barabarta prej 2.000 euro në vit, në total do të investojë 50.000 euro.

Tarifa hyrëse do të jetë 1.750,00 euro.

Kërkesa për blerje, tek Plani i kombinuar dorëzohet vetëm një herë, gjatë pagesës së parë të aseteve për aktivizimin e planit.

Plani i kombinuar përfundon kur investitori do të paguajë në total të gjithë shumën e parashikuar në planin investues ose kur do të kalojë periudha kohore për të cilën është lidhur.

Në rast të ndërprerjes së planit, investitori nuk ka të drejtë të kërkojë kthim të tarifës hyrëse të paguar ose të shfrytëzojë shkallën e përfitimit të tarifës hyrëse gjatë pagesës së ardhshme në fond.

11.4 Plani Investim +

Plani i Investim + paraqet kontratë blerje të kuotave në Fond në emër dhe për llogari të një pale të tretë, i cili me përfshirjen në këtë plan bëhet mbajtës i kuotave të Fondit, përkatësisht shfrytëzues i fundit.

Kjo kontratë lidhet ndërmjet subjektit juridik punëdhënës, shoqatës së punëdhënësve, shoqatës profesionale, sindikatave, shoqatave të qytetarëve, apo forma të tjera të organizimit. Në bazë të kësaj kontrate Organizatori detyrohet të paguajë një shumë të caktuar parash për blerjen e kuotave në fondin në emër dhe për llogari të shfrytëzuesit të fundit.

Shoqata është e detyruar që t'i investojë mjetet e paguara në përputhje me Ligjin dhe këtë Prospekt me qëllim realizimin e përfitimeve dhe minimizimin e rrezikut nga investimi.

Kërkesa për blerje, tek Plani Investim + dorëzohet vetëm një herë, gjatë pagesës së parë të aseteve për aktivizimin e planit.

Pagesa e parë pas planit të investimeve kryhen në nivel vjetor. Pagesat e ardhshme vjetore mund të paguhet në muaj, në tremujorë dhe gjashtë mujorë.

Shuma minimale për blerjen e kuotave nëpërmjet pagesës të planit investues është 1.350 LEK (10 Euro).

Organizatori është i detyruar të njoftojë Shoqërinë për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, marrëdhënies së biznesit, ose përfundimin e të gjitha pagesave të ardhshme në llogarinë e kujt do qoftë anëtari, në çfarëdo lloji baze. Anëtari i planit të investimeve të cilit i ka përfunduar marrëdhëniet e punësimit, marrëdhëniet e biznesit, si anëtar përfaqësues të organizatorit, mund të mbetet në Fond ose të aplikojë për blerje të kuotave të pjeshme ose të plota në pajtim me Rregulloren dhe Prospektin e Fondit.

Tarifa e hyrjes për dhënien e kuotave të pagesave sipas planit të investimeve llogaritet dhe paguhet me pagesën e parë për të gjithë shumën e kontratës për të investuar, me të cilën organizatori i planit të investimeve mund të fitojë kushte më të favorshme për blerjen e kuotave në varësi nga sasia e shumës së përgjithshme të rënë dakord në planin e investimeve, dhe në përputhje me tabelën në pikën 10.a.

11.5 Përrjashtime nga Tarifa Hyrëse

Shoqëria mund të zvogëlojë ose të përjashtojë nga pagesa e tarifës hyrëse investitorin në rast se punohet për investitorë të rëndësishëm, partnerë strategjikë si dhe kompani apo institucione financiare.

11.6 Kostot për Transferta nga një Fond në Fondin Tjetër të Administruar nga Shoqëria.

Mbajtësit e kuotave kanë mundësi të kryejnë transferata të kuotave nga një fond në fondin tjetër të administruar nga Shoqëria. Në rast të transferimit të kuotave nga një fond në një tjetër do të paguhet tarifa e hyrjes në përputhje me Prospektin dhe rregulloren e Fondit në të cilin do të hyjë.

12. POLITIKA E SHPËRNDARJES SË FITIMEVE TË FONDIT DHE PJESËMARRJES NË FITIMET E FONDIT

Kuotat e WVP Top Invest janë kuota akumulimi për të cilat të ardhurat nga investimi rinvestohen automatikisht dhe përfitimi tek investitorët vjen prej akumulimit të vlerës së këtyre kuotave.

13. MËNYRA DHE PROÇEDURA E INFORMIMIT TË MBAJTËSIT TË KUOTAVE

Shoqëria i njofton mbajtësit e kuotave të Fondit për:

- Raportimet vjetore, gjysmë-vjetore dhe tremujore për punën e Fondit;
- Vlerat ditore neto të aseteve të Fondit;
- Çmimin e dhënies dhe blerjes së kuotave;
- Ndërprerjen e blerjes dhe pagesat e kuotave;
- Ndryshimet në rregulloren dhe prospektin e Fondit; dhe
- Informacione të tjera të përcaktuara me ligjet dhe akte nënligjore.

Mbajtësit e kuotave gjithashtu mund të informohen në lidhje me çdo aspekt të punës së Fondit në mënyrat e mëposhtme:

- Në selinë e Shoqërisë;
- Në faqen e internetit të Shoqërisë;
- Media;
- Raportime On-line;
- Lajmërim me shkrim;
- Thirrje telefonike.

Procedura e informimit të mbajtësive të kuotave varet nga mënyra e zgjedhur e informimit.

Informacion prane Selisë së Shoqërisë

Të gjitha informacionet në lidhje me punën e Shoqërisë dhe Fondit, politikën e investimeve, informacionet publikuar nga mediumet etj, mund të merren në selinë e Shoqërisë në Rr. "Barrikadave" Nr. 118, Kati 4, Nr. 1, Tiranë, çdo ditë pune nga ora 09:00 deri 17:00.

Informacion në faqen e internetit të Shoqërisë

Informacionet në lidhje me veprimtarinë e Shoqërisë dhe Fondit janë gjithashtu në dispozicion në faqen e internetit të Shoqërisë: www.wvpfunds.al

Njoftime On-line

Mbajtësit e kuotave mund të parashtrojnë pyetjet e tyre dhe të marrin përgjigje nëpërmjet postës elektronike. Email i kompanisë është info@wvpfunds.al

Nëse pyetjet e shtruara lidhen me dhënien e të dhënave të mbajtësit të kuotave të cilat janë personale, adresa e e-mail duhet patjetër të regjistrohet në data bazën e Shoqërisë si një adresë për korrespondencë.

Ndryshime dhe plotësime në rregulloren dhe prospektin e Fondit

Në rast të sjelljes së vendimit për ndryshime dhe plotësime në Rregulloren dhe Prospektin e Fondit, Shoqëria do të njoftojë të gjithë mbajtësit e kuotave të Fondit në mënyrën e informacionit që ata vetë kanë zgjedhur, menjëherë pas miratimit të tyre, dhe para dorëzimit të kërkesës për miratim të ndryshimeve në Rregulloren dhe Prospekt të Fondit deri te AMF..

Së bashku me dorëzimin e ndryshimeve dhe plotësimet e Rregullores dhe Prospektit të Fondit, Shoqëria do të njoftojë mbajtësit e kuotave në Fond që ata do të jenë efektive vetëm nëse ato janë miratuar nga AMF dhe pas publikimit të tij, si dhe mundësinë që ata kanë për tu tërhequr nga fondi para hyrjes në fuqi të ndryshimeve dhe plotësimeve.

14. NJOFTIM PËR PERFORMANCËN DHE STRUKTURËN E FONDIT, SI DHE VENDIN DHE MËNYRËN E PUBLIKIMIT TË INFORMACIONEVE.

Performanca e Fondit mund të monitorohet çdo ditë nëpërmjet vlerës së kuotës, përkatësisht vlera neto e pronës për kuotë në Fond, publikuar në faqen e internetit të Shoqërisë. Informacioni mbi zhvillimin e Fondit, dhe strukturën e investimeve mund të merren në mënyrën dhe vendin siç përcaktohet në pikën 13.

15. TRAJTIMI FISKAL I FONDIT DHE MBAJTËSIT TË KUOTAVE

Fondi, për qëllime tatimi, konsiderohet si pronari i titujve ose i të gjitha aseteve, si dhe personi i fundit që përfiton prej saj, përveçse kur parashikohet ndryshe në legjislacionin tatimor.

Të gjitha fitimet e realizuara nga investimi në Fond, do të tatohen vetëm në momentin kur shpërndahen tek investitori, sipas Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi te ardhurat” i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

16. KOHËZGJATJA E VITIT FISKAL

Viti fiskal zgjat prej 01 Janar deri në 31 Dhjetor.

II. INFORMACIONE PËR SHOQËRINË E ADMINISTRIMIT TË FONDEVE

17. FORMA LIGJORE

WVP Fund Management Tirana sh.a – Shoqëri administruese e Fondeve Investuese është një shoqëri aksionare, me seli në Rr. "Barrikadave" Nr. 118, Kati 4, Nr. 1, Tiranë, Shqipëri.

18. DATA E THEMELIMIT TË SHOQËRISË

Shoqëria është themeluar në datën 24.01.2017

Shoqëria është themeluar për të ushtruar veprimtarinë e administrimit të fondeve investuese, si dhe punë të tjera në përputhje me Statutin e Shoqërisë si dhe Ligjin dhe rregulloret nënligjore.

19. KAPITALI I SHOQËRISË, TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SHOQËRISË

Kapitali themeltar i Shoqërisë është: 22.000.000 Leke i cili përbëhet nga depozita.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë administruese është mbledhja dhe investimi i fondeve të Investimit, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.10198, datë 10/12/2009 "Për sipërmarrjet e Investimeve Kolektive" si dhe në përputhje me parimin e diversifikimit të riskut me qëllim jo vetëm të marrin pjesë proporcionalisht në fitimet e fondit, por gjithashtu, të kërkojnë në çdo kohë shlyerjen e kuotave të tyre.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë administruese përfshin:

- administrimin e aseteve të sipërmarrjes së investimeve kolektive;
- marketimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe shitjen e kuotave në fondet e investimit ose të aksioneve në shoqëritë e investimit;
- kryerjen e detyrave administrative, që përfshijnë, ndër të tjera:
- mbajtjen e librave të llogarive kontabël dhe përgatitjen e raporteve financiare;
- përcaktimin e vlerës neto të aseteve dhe llogaritjen e çmimit të kuotave ose të aksioneve;
- përputhshmërinë e veprimtarisë së shoqërisë administruese me ligjet dhe rregulloret përkatëse;

- publikimet dhe raportimet tek aksionarët dhe mbajtësit e kuotave;
- pagesat për aksionarët ose mbajtësit e kuotave nga asetet apo fitimi i fondit;
- emetimin dhe shlyerjen e kuotave në një fond investimi dhe emetimin dhe shlyerjen e aksioneve në shoqëritë e investimit me ofertë publike;
- mbajtjen e regjistrit të mbajtësve të kuotave ose të aksionarëve;
- mbajtjen e të dhënave në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- organizimin e seminareve informative dhe trajnime bazë mbi fondet investuese për palët e interesuara;
- detyra të tjera të natyrës administrative, të miratuara nga AMF-ja.

20. ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE

Organet drejtuese të shoqërisë administruese janë: Asambleja e Aksionarëve, Këshilli i Administrimit dhe Administratorët.

20.1 Asambleja e aksionarëve

Asambleja e aksionarëve përbëhet nga përfaqësuesit ligjorë të aksionarëve të shoqërisë.

20.2 Këshilli i administrimit

Këshilli i Administrimit është organi qendror i shoqërisë administruese i cili kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare dhe zhvillimin e biznesit të shoqërisë administruese. Ai kujdeset që shoqëria administruese të respektojë ligjin dhe standartet e kontabilitetit, miraton politikat financiare, të investimit, prospektet e fondeve nën administrim etj.

Këshilli përbëhet nga pesë anëtarë si më poshtë:

- Rupert Strobl - Kryetar i Këshillit të Administrimit, Anëtar jo Ekzekutiv
- Arton Lena – Anëtar i Këshillit të Administrimit, Drejtor Ekzekutiv/Administrator
- Ognjen Tilic - Anëtar i Këshillit të Administrimit, Anëtar Ekzekutiv/Zv. Administrator
- Ardian Kelmendi - Anëtar i Këshillit të Administrimit, Anëtar jo Ekzekutiv
- Margarita Kola – Anëtare e Këshillit të Administrimit, Anëtar jo Ekzekutiv

MA Rupert Strobl - Kryetar i Këshillit të Administrimit, Anëtar jo Ekzekutiv

Lindur në datë 08.30.1954 në Graz të Austrisë, Magjistër i studimeve Sociale dhe Ekonomike në Universitetin e Graz-it. Karrierën e tij të punës e filloi si ekonomist në Dhomën për Punësim në Grac, që pastaj të punojë në kompaninë e sigurimeve WinerStädtische AG.

Që nga 1986 është i punësuar në WVP VersicherungsvermittlungGmbHGraz dhe nga viti 1989 deri më sot kryen funksionin si drejtor i përgjithshëm i të gjithë Grupit, WVP VersicherungsvermittlungGmbHGraz.

Mag. Strobl ka më shumë se 25 vjet përvojë për investime në bursat botërore. Ai është përgjegjës për politikën e investimit të fondit privat të investimeve WVP InvestVermögensverwaltungGmbH&Co. KEG që nga viti 1996. Me sukses menaxhon me kapitalin prej mbi 50 milionë euro dhe ka arritur një fitim mesatar vjetore neto prej 7.5% për investitorët e tyre. Ky sukses është si rezultat i strategjisë konservatore të investimit, blerja e "LargeCaps" – kompani të mëdha dhe të besueshme me një çmim atraktiv ku dhe gjatë kohës së recesionit ekonomik bëjnë fitime të mira dhe paguajnë dividendë për investitorët.

Përvojën e tij të gjatë dhe të suksesshme në investime në tituj në bursat ndërkombëtare do të shfrytëzojmë për fondin WVP Top Invest, ku është edhe kryetar i Komitetit të Investimit të WVP Fund Management Tirana sh.a.

MA Arton Lena - Drejtor Ekzekutiv i kompanisë:

I lindur në datë 27.09.1984, me diplomë universitare Master në Biznes Ndërkombëtar në Universitetin e Vjenës në Austri. Ka marrë pjesë në trajnime të shumta dhe seminare të specializuara nga investitorë dhe ligjërues të njohur në fushën e financave, sigurimeve, investimeve dhe retorikës në Austri, Angli, Gjermani, SHBA dhe Kroaci.

Arton Lena posedon Diplomë për këshilltar financiar dhe Broker nga Akademia e Bursës në Vjenë, Liçencë për tregtim në sistemin elektronik të Bursave Europiane - XETRA, Liçencë për agentë sigurimesh dhe Këshilltar Financiar në Vjenë, Austri; Ekspert i Liçencuar për Bashkimin Evropian (CIFE) Nica, Francë, dhe Liçencë për broker në Republikën e Maqedonisë.

Arton Lena ka më shumë se 10 vjet përvojë punë në fushën e menaxhimit të portofolit, investimeve, shitjes të produkteve financiare dhe siguracioneve.

Nga viti 2003 deri më 2006 ka punuar në WVP VersicherungsvermittlungGmbHGraz Austri si asistent i drejtorit të shitjes ku ka organizuar trajnime dhe seminare, ka qenë i ngarkuar me monitorimin e rregulloreve të legjislationit dhe ka përgatitur buxhetet vjetore.

Në vitin 2006 ka qenë i punësuar në AFB AG, AllgemeineFinanzierungsberatung, Wien, në pozicionin këshilltar Financiar dhe Agjent për ndërmjetësim në sigurime, ku bashkëpunonte me mbi 30 institucione financiare dhe ishte përgjegjës për administrimin e portofoleve individuale.

Nga viti 2008 është një ndërthemeluesit të shtëpisë brokere për tituj Eurohaus AD Shkup, anëtare në Bursën e Maqedonisë, ku deri në vitin 2010 ishte Menaxher perfaqësues për rajonin Gjermanofolos.

Nga viti 2010 deri në vitin 2011 ai ka punuar në Hedge fondin kanadez, ku fitoi njohuri profesionale nga fusha e investimeve dhe analiza teknike e titujve në bursat botërore.

Nga viti 2014 është themelues i WVP Fund Management AD Shkup dhe në funksionin e ChiefInvestmentManager - përgjegjës për administrimin e 3 fondeve investuese.

Përvojën e tij në investime dhe analizë teknike do ta shfrytëzojë për fondin WVP Top Invest, ku është edhe anëtar i Komitetit të Investimeve të WVP Fund Menagemet Tirana sh.a.

Ognen Tilic - Anëtar I Këshillit të Administrimit, Anëtar Ekzekutiv/Administrator

I lindur në datë 11.05.1987, me diplomë universitare ne Shkencat ekonomike dhe Master në Drejtesi Financiare në Universitetin e Shkupit "S. Cyril and Methodius" ne Maqedoni.

Në vitin 2010 – 2011 ka ndjekur trajnimin për Këshilltar financiar dhe Menaxhimin e portofolit i organizuar nga Komisioni i Letrave me Vlerë të Republikës së Maqedonisë në bashkëpunim me Bankën Botërore.

Nga viti 2011- 2014 ka punuar në industrinë financiare të administrimit të fondeve investuese si këshilltar financiar/Portfolio manager i licensuar.

Nga viti 2014 e ne vazhdim punon si këshilltar financiar/Portfolio manager i licensuar pranë kompanisë WVP FUND MANAGEMENT AD Shkup.

Ardian Kelmendi - Anetar I Keshillit te Administrimit, Anetar jo Ekzekutiv

I lindur në datë 23.03.1972, me diplomë universitare në Universitetin e Gracit, Gjermani "Karl-Franzens", Instituti për përkthime.

Ka kryer specializimin në Industrinë e Sigurimeve pranë Universitetit të Gracit, "Karl-Franzens" Gjermani.

Duke filluar nga viti 2003 deri më sot punon si menaxher i Rajonit për Shqipërinë dhe Kosovën pranë WVP- Versicherungs-Vermittlungs- GmbH në Grac;

Nga viti 2009 e në vazhdim është administrator i WVP Tirana sha, Broker në Sigurime.

Margarita Kola - Anetare e Keshillit te Administrimit, Anetar jo Ekzekutiv

Margarita Kola, ka kryer studimet Universitare dhe pasuniversitare në Kanada me grada Master në fushën Ligjore dhe është nëndjekje të doktoraturës për të Drejtën Ndërkombëtare në "RyersonUniversity ", Kanada.

Ka eksperiencë të gjatë si specilaiste Ligjore në kompani të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare (Ambasada Amerikane në Shqipëri, Ambasada Suedeze në Shqipëri etj) si dhe në sektorin Jofitimprurës.

Momentalisht punon si Drejtore ekzekutive pranë Kompanisë Kola & Associates law Firm.

21. INFORMACIONI MBI AKTIVITETET E SHOQËRISË

Në përputhje me Ligjit Nr.10198, datë 10/12/2009 "Për sipërmarrjet e Investimeve Kolektive" Shoqëria ushtron aktivitetin mbi themelimin dhe administrimin e fondeve investuese.

22. AUDITUESI

Audituesi i jashtëm i Fondit është GrantThornton sh.p.k, me seli në adresën: Rr. Sami Frashëri, Kompleksi T.I.D, Shk B, Kati 1, Tiranë, Shqipëri.

23. INFORMACIONE MBI DEPOZITARIN

Shoqëria administruese ka lidhur një marrëveshje për shërbimin e Depozitarit me Bankën FirstInvestmentBank – Albania sh.a., me seli në Bulevardin “Deshmorët e Kombit”, TwinTowers, Kulla 2, Kati 14. Depozitari është liçensuar nga Banka e Shqipërisë për të ofruar shërbimet e kujdestarisë, depozitimit dhe të besimit me Vendimin nr.13 datë 10.03.2010 si dhe është liçensuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ofruar shërbime depozitimi për fondet e investimeve me Vendimin nr. 175, datë 13.12.2011 në përputhje me ligjin 10198, date 10.12.2009 Për Sipërmarrjet e investimeve kolektive.

Veprimtaria e mbajtjes së aseteve dhe veprimtari të tjera, të zhvilluara nga depozitari, për shoqërinë administruese, për sa i përket strukturës organizative, veçohen nga veprimtaria e shoqërisë administruese. Asetet e Fondit, përfshirë llogaritë bankare dhe asete të tjera, ruhen dhe mbahen nga depozitari në një llogari të posaçme dhe nuk mund të përdoren as drejtpërdrejt, as në mënyrë të tërthortë për kryerjen e transaksioneve për llogari të tij, ose për të marrë ndonjë përfitim për vete a punonjësit e tij, apo për qëllime të tjera, përveç përfitimit të mbajtësve të kuotave. Asetet e Fondit që mbahen nga depozitari, kanë të drejtën e veçimit, si dhe nuk përfshihen në asetet e depozitarit, në procedurat e likuidimit ose të falimentimit, të nisura sipas legjislacionit shqiptar dhe as për zbatimin e pretendimeve ndaj depozitarit. Depozitari vepron vetëm në interes të mbajtësve të kuotave të Fondit.

Përveç ruajtjes së aseteve të Fondit, depozitari kryen edhe veprimtaritë e mëposhtme:

- Kontrolli nëse dhënia dhe blerja e kuotave në llogari të Fondit do të bëhet në përputhje me Ligjin dhe rregullat e Fondit;
- Garanton që llogaritja e vlerës neto të kuotave në Fond është shpallur në përputhje me ligjin, rregulloret përkatëse të AMF-së, prospektin dhe rregullat e Fondit;
- Ekzekuton urdhrat e Shoqërisë në lidhje me transaksionet me letrat me vlerë dhe asete të tjera që përbëjnë portofolin e Fondit, me kusht që ato të mos jenë në kundërshtim me Ligjin, rregulloren e AMF-së, Prospektin ose Statutin e Fondit;
- Siguron që transaksionet me letrat me vlerë do të jenë të likuiduara, dmth që kërkesat e arritura në të holla do të jenë të paguara në afatet ligjore ose kontraktuale;
- Informon Shoqërinë për aktivitetet që lidhen me asetet e Fondit dhe i zbaton urdhërat e tij;

- Pagan të gjitha të ardhurat dhe të drejtat e tjera të cilat maturohen në favor të Fondit dhe që rrjedhin nga pasuria e tij;
- Siguron që të ardhurat e Fondit të përdoren në përputhje me Ligjin, Rregulloren dhe Prospektin e Fondit kurse shpenzimet të cilat i pagan Fondit të jenë në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe kushtet të shprehur në Rregulloren dhe Prospektin e Fondit;
- Kryen detyra të tjera të parashikuara nga kontrata depozitare ndërmjet Shoqërisë dhe bankës Depozitare;
- Mban evidencë të punës të cilën e kryen si bankë Depozitare, për çdo fond individualisht dhe rregullisht e harmonizon me të dhënat e Shoqërisë;
- i raporton AMF-së për çdo shkelje të ligjit dhe të kontratës nga shoqëria administruese, në rast se kjo shoqëri refuzon të pranojë kërkesën e tij për ndërprerjen e kësaj shkeljeje.
- Auditorëve dhe personave të tjerë të autorizuar për të kontrolluar, duke përfshirë edhe AMF-në, u mundëson aksesin në të dhënat dhe llogaritë e lidhura me fondet e investimeve dhe pasurisë së tyre;
- Hap llogari për nevojat e Fondit në Bankë dhe në Qendrën depozitare për tituj;
- Pagan në llogari të veçantë mjete monetare nga shitja dhe blerja e kuotave të Fondit;
- Hap llogari të veçanta për mjetet monetare te bankat për tituj te depozituesit e titujve në vend dhe jashtë vendit dhe / ose banka nën-depozituese jashtë vendit;
- Në rast se nuk mund të realizohet likuidimi i Fondit nga ana e Shoqërisë për arsye të listuara në Ligj, Banka kryen likuidimin e Fondit në përputhje me Ligjin.
- Banka është përgjegjëse përpara Shoqërisë dhe zotruesve të kuotave të Fondit për dëmin që mund të lindë nga moskryerja ose kryerja e papërshtatshme e punëve të parashikuara në Marrëveshjen me Bankën depozitare.

III. INFORMACION PLOTËSUES

Informacioni në këtë Prospekt bazohet në ligj dhe në praktikat me të mira. Çdo person që lexon këtë Prospekt, duhet të verifikojë me WVP Fund Management Tirana Sh.a. se ky është versioni më i fundit dhe se nuk janë bërë rishikime apo ndryshime të tjera që nga momenti që ky Prospekt ka dale në qarkullim.

ETIKA DHE KONFLIKTI I INTERESIT

Punonjësit e përfshirë në procesin e investimit të aseteve nuk duhet të kenë paralelisht një aktivitet apo biznes personal i cili mund të jetë në konflikt me menaxhimin e investimeve në menyrën e duhur apo që mund të kufizojë aftësinë e tyre për të marrë vendime të paanshme.

KUJDESI

WVP Fund Management Tirana sh.a do ta menaxhojë Fondin WVP TOP Invest me kujdes ku çdo investim duhet bërë me gjykim dhe maturi, në të njëjtat rrethana kur një person i kujdesshëm, do të ushtronte me zgjuarsi dhe pjekuri administrimin e pasurive të veta, jo për spekulim, por për investim, duke konsideruar mundësitë e ruajtjes së kapitalit dhe mundësinë e të ardhurave që do të fitonte si rezultat i këtij investimi.

Fondi do të menaxhohet me profesionalizëm të denjë për besimin e publikut.

ANKESAT

Nëse keni një ankesë, ju lutem dërgojeni me shkrim në adresën e shoqërisë administruese, tek Rr. "Barrikadave" Nr. 118, Kati 4, Nr. 1, Tiranë. Të gjitha ankesat do të shqyrtohen dhe do t'iu jepet një përgjigje brenda 8 javëve nga data e mbërritjes së tyre.

DATA E DHËNIES SË PROSPEKTIT

Prospekti është miratuar në datë 31.01. 2018 , dhe është i vlefshëm nga dita e marrjes së të Vendimit për Miratimin e Prospektit nga ana e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare.